

FALËNDERIM

Autorët u falënderohen të gjithë bashkëpunëtorëve të përfshirë në procesin e realizimit të hulumtimit, veçanërisht shfrytëzuesve të shërbimeve të arsimit joformal (pjesëmarrësve në trajnime) dhe ofruesve të arsimit dhe trajnimit joformal, të cilët me përgjigjet e tyre mundësuan që të sigurohen të dhëna relevante për situatën.

Autorët i janë falënderues edhe Njesisë së projektit të E4E@mk, veçanërisht Anica Aleksovës për këshillat praktike dhe për mbështetjen profesionale.

Ekipi i cili zbatoi hulumtimin, të gjithë të punësuarit në Qendrën për Arsimimin e të Rriturve dhe të punësuarit në Njësine e projektit të E4E@mk shprehin keqardhje për humbjen e parakohshme të anëtarit të ekipit Rametulla Abduraimi.

Autorë të raportit:

Elena Rizova, Universiteti „Shën Kirili dhe Metodi”,
Fakulteti Filozofik - Shkup

Lindita Qazimi, Qendër për Arsimimin e të Rriturve

Rametulla Abduraimi, Qendër për Arsimimin e të Rriturve

Irena Millkov, Qendër për Arsimimin e të Rriturve

Maja Kërstevska, Qendër për Arsimimin e të Rriturve

Mevlane Zulfiqari, Qendër për Arsimimin e të Rriturve

Liljana Lazova, Qendër për Arsimimin e të Rriturve

Halit Jonuzi, Qendër për Arsimimin e të Rriturve

Hulumtimi dhe raporti janë përgatitur nga Qendra për Arsimimin e të Rriturve me mbështetje të projektit "Arsim për Punësim në Maqedoni" E4E@mk.

Qëndrimet e shprehura në këtë dokument janë të autorëve dhe nuk është e thënë të përputhen me mendimet dhe politikën e Projektit, zbatuesit e Projektit dhe donatorët.



PËRMBAJTJE

1. RËNDËSIA E ARSIMIT JOFORMAL TË TË RRRITURVE DHE ORIENTIMIT TË TIJ DREJT TREGUT DHE GJITHËPËRFSHIRJES	8
2. REALIZIM I HULUMTIMIT	11
3. REZULTATE	14
3.1. Orientim i tregut i programeve për arsimim joformal të të rriturve	14
Ofertë e shërbimeve/trajnimeve në arsimin joformal	16
Interes për shërbimet/trajnimet e ofruara për arsim joformale	17
3.2. Gjithëpërfshirje e programeve për arsimim joformal të të rriturve	23
3.3 Realizim i programeve për arsimim joformal të të rriturve	30
3.4 Bashkëpunim në kuadër të mjedisit shoqëror	32
REFLEKTIME PËRFUNDIMTARE	36
LITERATURA E SHFRYTËZUAR	39

Listë e shkurtesave

- APRM – Agjenci për Punësim
- ILO – Organizatë Ndërkombëtare e Punës
- AJFRR – Arsimim Joformal i të Rriturve
- AR – Arsimim i të Rriturve
- ATP – Arsimim dhe Trajnim Profesional
- AMP – Arsimim i Mesëm Profesional
- SHMP – Shkolla të Mesme Profesionale
- QARR – Qendër për Arsimimin e të Rriturve
- QATP – Qendër për Arsim dhe Trajnim Profesional

Kuptime kryesore


Ofrues të shërbimeve në AJFRR:

- a) institucioni për arsimimin e të rriturve është një shkollë, institucion i lartë arsimor, si dhe institucion i specializuar për arsimimin e të rriturve dhe
- b) institucioni për arsimimin e të rriturve është person juridik ose fizik që ka regjistruar veprimtarinë për arsimimin e të rriturve.

Shfrytëzues të shërbimeve të AJFRR-së – pjesëmarrësit në trajnime të organizuara nga ofruesit e shërbimeve (ofrues të verifikuar të trajnimeve).

Në Raportin, në përputhje me kontekstin e fjalisë, si sinonime përdoren termet:

- a) ofrues i shërbimeve në AJFRR, ofrues për AJFRR, ofrues;
- b) shfrytëzues të shërbimeve në AJFRR, pjesëmarrës në trajnime, shfrytëzues përfundimtar.



PARATHËNIE

Në kuadër të bashkëpunimit dhe mbështetjes së Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në fillim të muajit mars të vitit 2018 filloi të realizohet projekti "Arsim për Punësim në Maqedoni" [E4E@mk]¹. Qëllimi kryesor i Projektit është që të kontribuojë në punësimin më dinjitoz e të rinjve, e veçanërisht të grupeve të rrezikuara, në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme sociale. Kjo pritet të arrihet përmes qasjes sistemore që do të synojë të sigurojë zhvillim të shkathtësive profesionale që janë më shumë me orientim drejt tregut, përmes arsimit dhe trajnimeve joformale, bashkëpunimit të përmirësuar mes arsimit të mesëm profesional dhe punëdhënësve, veçanërisht në pjesën e mësimin praktik të nxënësve, si dhe përmes kornizës së përmirësuar ligjore për zhvillimin e shkathtësive profesioanale. Në fazën e tij të parë (2018–2022), në fokus të veçantë të Projektit janë 7 sektorë (shëndetësia dhe kujdesi social, shërbimet personale, veprimtaria hoteliere, sektori bujqësor, sektori ushqimor-teknologjik, sektori i makinerisë dhe elektroteknikës – IT-profile) në 4 rajone të planifikuara në shtet (Juglindje, Jugperëndim, Pollog dhe Shkup). Projekti është realizuar nga interkorporata zvicerane "Helvetas" në partneritet me Qendrën Maqedonase për Edukim Qytetar dhe Oda Ekonomike e Maqedonisë, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Qendrës së Arsimit dhe Trajnimit Profesional, Qendrës për Arsimimin e të Rriturve, sektorit afarist dhe organizatave të tjera relevante qeveritare dhe joqeveritare.

Njëri prej aktiviteteve të rëndësishme fillestare të Projektit ishte që të merren informacione relevante për situatën dhe qëndrimet e ofruesve

¹ Më tutje në dokument E4E@mkose Projekti.

dhe shfrytëzuesve të trajnimeve në arsimin joformal dhe për orientimin e tij drejt tregut dhe aspektin gjithëpërfshirës të trajnimeve. Duke marrë parasysh qasjen sistemore, njësia e projektit e E4E@mk ia ndau realizimin e hulumtimit IP Qendrës për Arsimimin e të Rriturve të cilëve u siguroi mbështetje nga një ekspert i jashtëm. Aktivitetet hulumtuese dhe përpunimi i të dhënave që janë marrë përfshin qasje gjithëpërfshirëse të konsultimeve dhe analizave të qëndrimeve të të gjitha palëve të prekura në ofertën dhe realizimin e arsimimit joformal të të rriturve (ofrues të trajnimeve, shfrytëzues të shërbimeve, komuna dhe shkolla të mesme profesionale) me fokus të veçantë në ofruesit e shërbimeve/ofrues, si dhe të shfrytëzuesve të programeve (pjesëmarrës në trajnime).

Ekipi hulumtues përpiloi dhe zbatoi instrumente për grumbullimin e të dhënave që kanë të bëjnë me qëndrimet e: ofruesve të verifikuar të shërbimeve për arsimimin e të rriturve, shfrytëzuesve të programeve për arsimim joformal të të rriturve, përfaqësuesve të institucioneve për arsim dhe trajnim formal profesional, komunave në të cilat ofrohen programe për arsimim joformal të të rriturve; si dhe grupeve të fokusit me përfaqësues të ofruesve të shërbimeve për arsimimin e të rriturve. Të dhënat janë grumbulluar përmes softuerit përkatës përmes punës në terren të ekipit hulumtues.

Hulumtimi është i karakterit sasior dhe cilësor, ku krahas qëndrimeve që janë marrë si përgjigje të pyetjeve në pyetësorët, përdoren edhe teknika cilësore hulumtuese (intervistë dhe grupe të fokusit), si dhe studim të literaturës dhe hulumtimeve relevante paraprake me qëllim që të arrihet triangulacion për objektivizimin e të dhënave që janë marrë.

Ky Raport rezulton nga analiza e të dhënave të grumbulluara dhe ka për qëllim të përgjigjet në pyetjet që do të ndihmonin në realizimin e aktiviteteve në drejtim të përmirësimit të funksionimit të përgjithshëm të arsimit dhe trajnimit joformal nga aspekti i efektivitetit, relevancës, gjithëpërfshirjes dhe cilësisë së tij.

1 RËNDËSIA E ARSIMIT JOFORMAL TË TË RRITURVE DHE ORIENTIMIT TË TIJ DREJT TREGUT DHE GJITHËPËRFSHIRJES



Ndryshimet e shpejta në raport me kërkesat e shkathtësive dhe kompetencave të reja në fushën e punës, që janë të kushtëzuara kryesisht nga zhvillimi i konsiderueshëm i teknikës dhe teknologjisë, e vendosin sistemin arsimor (veçanërisht arsimin dhe trajnimin profesional dhe arsimimin e të rriturve) para një sfide të madhe - Si të aftësohen të rinjtë me shkathtësi dhe kompetenca që janë të nevojshme për tregun e punës së të ardhmes?

Ekonomitë evropiane dhe botërore gjithnjë e më shumë mbështeten në fuqinë rrimedituese që e ka arsimimi joformal dhe trajnimi për plotësimin e zbrazëtive të arsimit formal, si dhe "mbajtjen e hapit" me profesionet e reja dhe bashkëkohore që janë kushtëzuar nga mënyra e re në të cilën jetojmë, mësojmë dhe punojmë. Përmes arsimit dhe trajnimit joformal, të rinjtë dhe të moshuarit mund të përvetësojnë kompetenca dhe t'i avancojnë ato, të marrin kualifikim përkatës dhe të bëhen konkurrent në tregun e punës, por kjo shërben edhe si mjet për zhvillim dhe plotësim personal, si dhe qytetari aktive. Kjo, mes tjerash, është e mundshme për shkak të fleksibilitetit më të madh të tij dhe mundësisë për aftësim më të shpejtë si ndaj nevojave të pjesëmarrësve në trajnimet, ashtu edhe ndaj nevojave të tregut të punës/punëdhënësve.

Sot, më shumë se kurdoherë, është me rëndësi kyçe që të gjithë qytetarët të marrin arsim dhe trajnim të lartë cilësor që të pajisen me kompetenca kyçe që u nevojiten për të qenë aktiv në aspektin ekonomik dhe të zellshëm, si dhe të përmirësojnë jetën në tërësi. Si pasojë e kësaj, secili vend duhet të fokusohet në forcimin e vazhdueshëm të fuqisë punëtore me dituri, shkathtësi dhe qëndrime, që nuk mund të përvetësohen vetëm përmes sistemit formal arsimor².

Në një kohë të turbulencave të theksuara ekonomike të përcjella me kriza, e edhe me nevoja që vështirë parashikohen, bota përballet me sfida serioze lidhur me punësimin dhe me deficitin e madh të vendeve të punës. Tre vitet (pas vitit 2012) e situatave të vazhdueshme të krizës në tregjet globale të fuqisë punëtore shkaktuan rritje të papunësisë për 27 milionë persona, krahasuar me fillimin e krizës, e cila, sipas projeksionit të ILO-së, do të rritet edhe në vitin 2019 dhe do të arrijë, në suaza botërore, rreth 200 milionë të papunë³.

² Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Strategji për arsim dhe trajnim profesional në kontekst të nxënies së përgjithshme 2017-2020, Shkup: MASH, QATP dhe FET

³ ILO: World Employment and Social Outlook: Trends 2019, International Labour Office, Gjenevë .

Në vitin 2017, në botë, më shumë se 80 milionë të rinj të moshës prej 15 deri 24 vjeç janë të papunë. Norma globale e papunësisë së të rinjve, prej 13.4 për qind, është për dy për qind më e lartë se niveli para krizës ekonomike⁴. Në analizën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës mund të vërehet se vazhdojnë pabarazitë në tregun e punës në bazë gjinore, të moshës, sektorit dhe në ndonjë bazë tjetër. Dallimet gjinore janë të rëndësishme së veçantë, meqë në nivel global ende ekziston dallimi i konsiderueshëm në papunësinë mes personave burra dhe gra (më shumë se 26 pikë procentuale), që do të thotë diskriminimi gjinor është ende i pranishëm jo vetëm në vendet e pazhvilluara dhe vendet në zhvillim por edhe në vendet e zhvilluara në botë. Mungesa e mundësive për punësim është njëra prej sfidave më të mëdha globale për të rinjtë në fushën e punës. Gjasat për punësimin e më të rinjve (me normë globale të papunësisë prej 13 për qind) janë shumë më të vogla për dallim nga të moshuarit, (normë prej 4,3 për qind).

Trendet demografike, të cilat karakterizohen me përqindje gjithnjë e më të madhe të popullatës së moshuar, gjithashtu kontribuojnë për rritjen e presionit të tregut të punës. Me fjalë të tjera, si rezultat i jetëgjatësisë së njeriut dhe rritjes së zvogëluar të popullatës në botë, rritja botërore e popullatës është në rënie të konsiderueshme dhe trajektorja e tillë pritet të vazhdojë edhe në disa dekadat e ardhshme. Vlerësohet se në vitin 2030⁵, në vendet e zhvilluara në botë, pesë prej dhjetë të punësuarve në tregun e punës do të jenë mbi moshën 65 vjeç, për dallim nga 3,5 nga dhjetë të punësuar në vitin 2017. Kjo do të thotë se para popullatës së moshuar vendosen sfida të reja që e detyrojnë t'i modernizojë kompetencat e saj në kontekst të inovacioneve dhe ndryshimeve strukturore në tregun e punës.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas vlerësimit të fundit të popullatës⁶ (gjendja më 31.12. të vitit 2017), ka 2 075 301 banorë, ndërsa sipas strukturës për nga gjinia 50,1% janë burra, ndërsa 49,9% gra. Mosha mesatare e popullatës është 39 vjeç, me trend të rritur të plakjes. Për shkak të kësaj, vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet çështjes së përmirësimit të kushteve për jetesë dhe punë për të rinjtë. Sipas analizës me titull "Serioziteti i gjendjes me të rinjtë të cilët janë jashtë arsimit, trajnimeve dhe janë të papunë: Si të përballeni me këtë?" (B. Novkovska, 2017)⁷, „Pjesëmarrja e të rinjve të moshës prej 15 deri 24 vjeç në popullatën e përgjithshme të aftë për punë është në rënie të vazhdueshme. Kështu, në vitin 2016 ajo arrin 16,3 %, në krahasim me 19,0 % në vitin 2011. Njëherësh, sistemimi i të rinjve, sipas statusit ekonomik në tregun e punës, tregon se 68,7 % janë joaktivë; 16,2 % janë të punësuar dhe 15,1 % janë të papunë; gratë janë më pak aktive në tregun e punës dhe janë me mundësi më të vogël sesa burrat për të gjetur punë. Norma e papunësisë së të rinjve [15–24 vjeç] në Maqedoni ishte 48,2 % në vitin 2016 dhe është dukshëm mbi atë të vendeve të BE-së ku norma e papunësisë është 18,7 %“.

Njëherësh, arsimit dhe trajnimi profesional i nënshtrohen një vargu të reformave gjatë dekadës së shkuar, e edhe sot. Strategjia për arsim dhe trajnim profesional viti 2013–2020 në kontekst të nxënies së përjetshme detektoi një varg dobësish në këtë fushë dhe me të u trasua zhvillimi i ATP-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas trendeve evropiane dhe botërore. Banka Botërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut e mbështeti QATP-në, që të përpilojë Konceptcion për modernizimin e arsimit teknik; përpilohen standarde të kualifikimit sipas drejtimeve evropiane për krijimin e standardeve për fuqi punëtore adaptuese dhe konkurrenente,

4 International Labour Organization, ILOSTAT database. Data retrieved in September 2018.

5 World employment social outlook – trends 2018, International labour office, Geneva.

6 Burimi:Enti Shtetëror për Statistikë, http://www.stat.gov.mk/Publikacii/MakStat_IZBOR_2018.pdf

7 Blagica Novkovska. 2017. Severity of the Issue of Excluded Young People in Macedonia from Education, Trainings and Employment: How to Cope With? UTMS Journal of Economics 8 (3), 295–306.

etj⁸. Ndryshimet strategjike në arsimin dhe trajnimin profesional duhet të rezultojnë me nivel fleksibil dhe transparent të arsimit të mbështetur në parimet e nxënies së përgjeshme, përshtatjen e nevojave individuale dhe nevojave të tregut të punës në nivel nacional dhe lokal. Arsimi i këtyre profesional, si dhe arsimimi dhe trajnimi i të rriturve duhet të mbështesë zhvillimin shoqëroro-ekonomik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke u afuar nxënësve/pjesëmarrësve, mundësi që të përvetësojnë dituri, shkathtësi dhe kompetenca të domosdoshme për ushtrimin e punës – kualifikime të nevojshme në tregun e punës, por edhe për vazhdimin e arsimit.

Ndonëse arsimimi i të rriturve, jo vetëm që është i rëndësishëm, por është edhe element strategjik për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror në shtet, ende mungon orientim më i madh, interes për të, si dhe përkushtim i vërtetë për zhvillimin e tij. Kjo, mes tjerash, shkakton rritje të strukturës së pavolitshme arsimore të popullatës, ristrukturim të pamjaftueshëm efikas të fuqisë punëtore, si dhe mungesë të mundësive më të mëdha për mbrojtje të mirëfilltë të grupeve marginale dhe të rrezikuara. Arsimitimi i të rriturve duhet të pranohet si arsimim me interes të veçantë shoqëror që është pjesë e politikave globale për zhvillim ekonomik. Parimi gjithëpërfshirës në arsimin dhe trajnimin profesional dhe arsimimin e të rriturve nënkupton përfshirjen e të gjithëve dhe zhvillimin e vetëdijes më të lartë për lidhshmëri, varësi dhe solidaritet të ndërsjellë, pa marrë parasysh: racën, gjininë, pengesën, përkatësinë sociale, etnike, religjioze dhe kulturore, si dhe gjendjen materiale dhe shëndetësore. Gjithëpërfshirja në fakt paraqet sigurim të qasjes, kushteve për përfshirje të mirëfilltë dhe përpjekje për arritjen e rezultateve të të gjithë nxënësve/

jesëmarrësve në procesin e mësimdhënies dhe

⁸ Arsim dhe trajnim i mesëm katërvjeçar.


trajnimin⁹.

Hulumtimi për Arsimimin e të rriturve¹⁰ në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i zbatuar në vitin 2016, siguroi një pasqyrë më të madhe për popullatën që merr pjesë në trajnimin për të moshuar:

- ▶ Pjesëmarrja e përgjithshme në arsimin dhe trajnimin joformal të popullatës të moshës prej 26 deri 64 vjeç është vetëm 12,7%.
- ▶ Nga perspektiva territoriale ekziston një hendek i qartë mes popullatës urbane (76% e pjesëmarrësve në arsimin për të moshuar) dhe popullatës rurale.
- ▶ Ndarja sipas nivelit të arsimit tregon se: 59% e pjesëmarrësve janë me arsim të lartë, 38% kanë arsim të mesëm dhe vetëm 3% janë nën arsimin e mesëm.
- ▶ Ekziston hendek minimal gjinor (46% gra).
- ▶ Statusi i shumicës së pjesëmarrësve në arsimimin për të moshuar është "i punësuar" (79%), vetëm 14% e shfrytëzuesve janë joaktivë dhe vetëm 7% janë të papunë.

⁹ Në përputhje me sistemin trepalësh të OECD-së për përcaktimin e personave për të cilët nevojitet gjithëpërfshirje më e madhe që (veçanërisht në sistemet e arsimit dhe trajnimin) i përfshinë kategoritë vijuese: A/handikap: Persona/nxënës me pengesë ose dëmtim shikuar nga aspekti mjekësor si çrregullime organike që janë pasojë e patologjive organike (për shembull, në raport me mangësi sensorike, motorike ose neurologjike). Konsiderohet se nevoja e personave rezulton kryesisht nga problemet që mund t'i përshkruhen handikapit të këtyre. B/vështirësi: Persona/nxënës me çrregullime në sjellje dhe emocione ose vështirësi specifike në nxënie. Vështirësitë kryesisht kanë të bëjnë me bashkëveprimin mes personit/nxënësit dhe mjedisit/konteksti arsimor. C/mangësi: Persona/nxënës me mangësi, të cilët kryesisht rezultojnë nga faktorët socio-ekonomik, kulturor dhe/ose lingvistik.

¹⁰ Adult Education Survey, 2016 – Burimi: Enti Shtetëror për Statistikë



2 REALIZIM I HULUMTIMIT



Hulumtimi për orientimin drejt tregut dhe gjithëpërfshirjen e programeve për arsimim joformal të të rriturve është realizuar në tri faza:

- ▶ Faza e parë ka të bëjë me përcaktimin e metodologjisë, krijimin e instrumenteve, detektimin e grupeve qëllimore të të anketuarve (ekzemplari i hulumtimit) dhe formimi i bazës me informacione për të anketuarit/pjesëmarrës, të cilët kanë qenë të trajnuar në kuadër të AJFRR-së në vitin 2017 dhe 2018;
- ▶ Faza e dytë paraqet grumbullimin e të dhënave nga të anketuarit;
- ▶ Faza e tretë ka të bëjë me analizën dhe interpretimin e rezultateve që janë marrë.

Ekzemplarë

Në sistemin për arsim joformal – arsimimin e të rriturve, në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga viti 2017 e deri në shtator të vitit 2018 janë verifikuar gjithsej 125 programe për arsim joformal. Kanë pasur gjithsej 1534 shfrytëzues të shërbimeve të AJFRR-së (pjesëmarrës në trajnimet).

Ekzemplari i shfrytëzuar në këtë hulumtim është shtresuar sipas sektorëve dhe rajoneve relevante për projektin E4E@mk11, por edhe rregulluar, sipas të dhënave të kapshme të QARR-së për ofrues të verifikuar të shërbimeve dhe shfrytëzues që i kanë ndjekur trajnimet për arsimim joformal të të rriturve në sektorët dhe rajonet e projektit.

Të dhënat që i ka në dispozicion QARR-ja tregojnë se nga viti 2017 e deri në shtator të vitit 2018 në sektorët dhe rajonet e projektit:

- ▶ kanë qenë aktivë 31 ofrues të shërbimeve, ndërsa hulumtimi ka përfshirë 29 (ose 93,54 % të ofruesve aktivë të shërbimeve), duke përfshirë edhe 7 shkolla të mesme që janë ofrues të verifikuar të shërbimeve;
- ▶ numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në trajnimet ka qenë 432, për të cilët me ndihmën e ofruesve u formua një bazë e të dhënave, në hulumtimin janë përfshirë dhe janë grumbulluar të dhëna nga 113 (ose 26,15 %) pjesëmarrësve në trajnimet;

¹¹ Sektorë: shëndetësi dhe përkujdesje sociale, shërbime personale, hotelieri, sektor bujqësor, sektor ushqimor-teknologjik, sektor i makinerisë dhe elektroteknikës- IT-profile; rajone malore: Juglindje, Jugperëndim, Pollog dhe Shkup.

- ▶ në katër rajonet ka 10 mjedise më të mëdha urbane, ndërsa në hulumtimin janë përfshirë përfaqësues nga Ohri, Struga, Tetova dhe Qyteti i Shkupit; dhe
- ▶ të dhënat janë grumbulluar nga përfaqësuesit e gjashtë shkollave profesionale, që nuk janë ofrues të shërbimeve për arsimim joformal të të rriturve.

Në mënyrë plotësuese, në kuadër të grupeve të fokusit janë përfshirë 23 ofrues të shërbimeve për AJFRR nga katër rajonet.


Sistemimi rajonal i të anketuarve/pjesëmarrësve në trajnimet të cilët janë përgjigjur në pyetësorin, sipas gjinisë, është paraqitur në tabelën 1 dhe Grafikonin 1 (dy prej të anketuarve nuk e kanë cekur gjininë).

Grafikon 1. Ekzemplari i shkollave të mesme profesionale, të përfshira në hulumtimin, që kanë verifikuar programe për AJFRR janë nga rajonet vijuese: Juglindje (2 shkolla), Pollog (2 shkolla) dhe Rajoni i Shkupit (3 shkolla).

Tabela 1: Përqindje e të anketuarve të përfshirë sipas rajonit dhe gjinisë

Gjinia	Shkup	Pollog	Jugperëndim	Juglindje	TOTAL
Mashkullore	38,5 %	38,5 %	0,0 %	23,1 %	100%
Femërore	61,2 %	21,2 %	1,2 %	16,5 %	100%

Grafikon 1. Numër i të anketuarve të përfshirë sipas rajonit, sipas gjinisë



Instrumente që janë përdorur në hulumtimin

Për grumbullimin e të dhënave, janë shfrytëzuar dy lloje të instrumenteve me qëllim që të fitohet triangulacion metodologjik gjatë procedimit të mëtejshëm të të dhënave: pyetësor – skaler dhe dhe protokoll për intervistë të strukturuar. Me fjalë të tjera, janë përpiluar 4 pyetësorë të dedikuar për katër grupe qëllimore nga ekzemplari (më hollësisht në tabelën 2): ofrues të verifikuar të shërbimeve për arsimim joformal të të rriturve: shfrytëzues të programeve për arsimim joformal


të të rriturve (pjesëmarrës në trajnimet); përfaqësues të komunave dhe përfaqësues të arsimit të mesëm profesional.

Anketimi është realizuar përmes rrugës elektronike gjatë periudhës prej tetorit deri në nëntor të vitit 2018. Të dhëna specifike sasiore u morën edhe përmes intervistave, gjegjësisht realizimit të 4 grupeve të fokusit me ofruesit e shërbimeve për arsimim joformal të të rriturve nga katër rajonet e Projektit.

Tabela 2: Përshkrim i instrumenteve të shfrytëzuara

Kod	Të anketuar	Përshkrim i instrumentit
AA	Ofrues të shërbimeve për arsimimin e të rriturve	<ul style="list-style-type: none"> Tetë pyetje me të cilat grumbullohen informacione të përgjithshme (statusi i organizatës, rajon, sektor/profil në të cilin ofrojnë trajnim, sektor/profil me numër më të madh të pjesëmarrësve në vitin 2017 dhe 2018, numër i përgjithshëm i programeve të ofruara për trajnim, mënyrë e vendimmarrjes për ofertë të programeve dhe numër i përgjithshëm i pjesëmarrësve dhe specifika për pjesëmarrësit: gjini, status socio-ekonomik, përkatësi etnike, pengesë, status i të punësuarve/të papunëve). Shkallë pesëgradëshe e Likertit me 14 pika për informacione specifike lidhur me orientimin drejt tregut, gjithëpërfshirjen dhe cilësinë e ofertës.
AE	Ofrues të shërbimeve për arsimimin e të rriturve	<ul style="list-style-type: none"> Protokoll për intervistë të strukturuar me të cilën grumbullohen informacione të përgjithshme (status i organizatës, rajon, sektor/profil në të cilin ofrojnë trajnim, sektor/profil me numër më të madh të pjesëmarrësve më 2017 dhe 2018) si dhe 5 tema për diskutim që shpijnë deri te marrja e informacioneve lidhur me orientimin e tregut, gjithëpërfshirjen dhe cilësinë e ofertës.
AB	Shkolla të mesme profesionale	<ul style="list-style-type: none"> Pesë pyetje me të cilat grumbullohen informacione të përgjithshme (komunë, sektorë/profile të përfaqësuara në shkollë, sektor/profil me numër më të madh të nxënësve në vitin 2017 dhe 2018, numër të përgjithshëm të nxënësve që kanë mbaruar më 2017 dhe janë regjistruar më 2018, specifika për nxënësit: gjini, status socio-ekonomik, pengesë, përkatësi etnike). Shkallë pesëgradëshe e Likertit me 15 pika për informacione specifike lidhur me orientimin e tregut, gjithëpërfshirjen dhe cilësinë e ofertës.
AC	Shfrytëzues të programeve për AJFRR	<ul style="list-style-type: none"> Nëntë pyetje me të cilat grumbullohen informacione të përgjithshme (gjini, moshë, rajon, përkatësi etnike, niveli i arsimimit, sektor/profil nga i cili ka qenë trajnimi, status i të papunëve, informim për trajnimin). Shkallë pesëgradëshe e Likertit me 11 pika për informacione specifike lidhur me orientimin e tregut, gjithëpërfshirjen dhe cilësinë e ofertës.

-
- | | | |
|----|--------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| AD | Komuna | <ul style="list-style-type: none">▶ Pesë pyetje me të cilat grumbullohen informacione të përgjithshme (komunë, sektor/profil në të cilin ofrohen trajnime, sektor/profil me numër më të madh të nxënësve në vitin 2017 dhe 2018, numër të përgjithshëm të programeve të ofruara për trajnim, numër të përgjithshëm të pjesëmarrësve dhe specifika për pjesëmarrësit: gjini, status socio-ekonomik, status gjeografik, përkatësi etnike, pengesë, status të të papunëve).▶ Shkallë pesëgradëshe e Likertit me 7 pika për informacione specifike lidhur me orientimin e tregut, gjithëpërfshirjen dhe cilësinë e ofertës. |
|----|--------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
-



3

REZULTATE



Analiza dhe interpretimi i të dhënave është e fokusuar drejt asaj që të jepen përgjigje në pyetjet hulumtuese që kanë të bëjnë me katër tregues:

1. Orientim drejt tregut i programeve për arsimim joformal të të rriturve.
2. Gjithëpërfshirje e programeve për arsimim joformal të të rriturve.
3. Realizim i programeve për arsimim joformal të të rriturve.
4. Bashkëpunim me mjedisin më të gjerë shoqëror.

3.1. Orientim i tregut i programeve për arsimim joformal të të rriturve

Orientimi drejt tregut i programeve të AJFRR-së është njëri prej treguesve kryesorë të suksesit, atraktivitetit dhe plasmanit të kapitalit njerëzor në tregun e punës. Ndonëse kjo problematikë është shumë komplekse dhe kërkon hulumtim rrënjësor dhe analizë të situatave edhe nga aspekti i punëdhënësve si “shfrytëzues përfundimtar”, për nevojat e këtij hulumtimi janë analizuar qëndrimet e ofruesve të trajnimeve/ofruesve në AJFRR dhe shfrytëzuesit/pjesëmarrësit në trajnimet.

Për ofruesit e shërbimeve të AJFRR, orientimi drejt tregut i ofertës, në fakt është i dyanshëm: nga njëra anë është i orientuar drejt shfrytëzuesve të shërbimeve/pjesëmarrësve në trajnime, e nga ana tjetër drejt nevojave të punëdhënësve.

Lidhur me orientimin e programeve për arsimim joformal drejt tregut të punës, gjegjësisht kërkesës së kompanive, në secilin prej instrumenteve kishte grup të pyetjeve. Gjatë analizimit të përgjigjeve është bërë një indeks i agreguar

nga pyetjet (pikat) përkatëse dhe është bërë zhvendosje plotësuese e nivelit të pajtueshmërisë nga të anketuarit në shkallën prej 1 deri 4 (përgjigjet në kategorinë “nuk kam mendim” janë të koduara).

Përshkrim më i hollësishëm i pyetjeve në pyetësorët që janë përdorur për indeksin e orientimit drejt tregut është paraqitur në tabelën 3, ndërsa përgjigjet e të anketuarve në Grafikonin 2.

Tabela 3: Pyetje lidhur me orientimin drejt tregut

Kod	Të anketuar	Përshkrim i pikave në instrumentin
AA	Ofrues të shërbimeve për arsimimin e të rriturve	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Kërkesa e tregut të punës për programet e ofruara ▶ Aktualitet i programeve të ofruara ▶ Përdorim i analizave, konsultimeve me punëdhënësit dhe arsimin e lartë për kuadrot e nevojshme/deficitare në shtet ▶ Përdorim i veglave, materialeve, pajisjes bashkëkohore në përputhje me nevojën e vendit të punës
AB	Shkolla të mesme profesionale	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Kërkesa e tregut të punës për profesionet/profilet që i ofron shkolla ▶ Aktualitet i programeve të ofruara dhe/ose nevojë për përshtatjen e tyre ▶ Konsultime me punëdhënësit dhe arsimin e lartë për kuadrot e nevojshme deficitare në shtet ▶ Niveli i përdorimit të veglave, materialeve, pajisjes bashkëkohore në përputhje me nevojën e vendit të punës ▶ Trajnim praktik në kompani ▶ Mundësi për punësimin e nxënësve në profesion/profil përkatës
AC	Shfrytëzues të programit për AJFRR	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Dituritë, shkathhtësitë dhe qëndrimet e përvetësuara kanë ndihmuar për punësim/avancim më të shpejtë në vendin e punës ▶ Nevoja për sendërtim të kompetencave për shkak të punësimit/avancimit më të lehtë ▶ Gjatë trajnimit përdorim të veglave, materialeve, pajisjes bashkëkohore në përputhje me nevojën e vendit të punës
AD	Komuna	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Kërkesa e tregut të punës në komunë për programet e ofruara ▶ Bashkëkohësi e programeve të ofruara ▶ Përdorim i analizave, konsultimeve me punëdhënësit dhe arsimin e lartë për kuadrot e nevojshme/deficitare në komunë


Në bazë të indeksit konstatohet se:

- ▶ për 44,4 % e ofruesve (ofrues të shërbimeve), oferta është e orientuar tërësisht drejt tregut të punës; dhe
- ▶ 45,4 % e shfrytëzuesve të arsimit joformal janë dakord se trajnimi që e kanë kaluar është tërësisht i orientuar drejt tregut të punës.
- ▶ Mund të konstatohet se krahas pajtueshmërisë së madhe në kategorinë “tërësisht po”

dhe “kryesisht jo” në mesin e ofruesve dhe shfrytëzuesve të AJFRR-së, ofruesit nuk janë sa duhet kritik në raport me ofertën personale të trajnimeve krahasuar me përgjigjet e pjesëmarrësve në trajnimet.

- ▶ Më tutje, në këtë pjesë të Raportit, janë analizuar në mënyrë më të hollësishme aspektet dhe përgjigjet e të anketuarve lidhur me orientimin e tregut të ofertës.

Grafikon 2. Vlerësim i ofruesve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve për orientim drejt tregut të trajnimeve




Ofertë e shërbimeve/trajnimeve në arsimin joformal

Sipas Ligjit për arsimimin e të rriturve, ofrues të shërbimeve/trajnimeve për arsimim joformal të të rriturve mund të jenë institucione të ndryshme: a) institucion për arsimimin e të rriturve është një shkollë, institucion i lartë arsimor, si dhe institucione të specializuara për arsimimin e të rriturve dhe b) institucion për arsimimin e të rriturve është një person juridik ose fizik që ka

regjistruar veprimtari për arsimimin e të rriturve.

Statusi i ofruesve të shërbimeve të përfshirë në hulumtimin, sipas përgjigjeve të tyre në pyetësorin, është paraqitur në Grafikonin e mëposhtëm.

Grafikon 3: Përqindje e të anketuarve / ofruesve për AJFRR sipas statusit të institucionit të tyre



PËRQINDJE E TË ANKETUARVE

Nga Grafikoni mund të konstatohet se pjesa më e madhe e ofruesve të shërbimeve për AJFRR të përfshirë në hulumtimin janë përgjigjur se janë kompani, një pjesë janë universitetet e hapura për nxënie të përhjetshme, derisa më së paku janë përgjigjur se janë nga sektori joqeveritar. Në kategorinë "tjetër", në kërkesën që të përmendet çfarë – janë përmendur oda dhe shoqata për arsimim dhe trajnim.

Në raport me shpërndarjen rajonale të ofruesve të AJFRR-së, pjesa më e madhe e tyre janë nga Rajoni i Shkupit (60 %), derisa një numër më i

vogël janë nga Pollogu (30 %) dhe Juglindja (10 %). Nuk ka fare ofrues të verifikuar të shërbimeve nga Rajoni Jugperëndimor në vitin 2017 dhe 2018.

Lidhur me ofertën e shërbimeve për arsimim joformal të të rriturve, sipas përgjigjeve të të anketuarve, gjysma ofrojnë trajnime në sektorin shërbime personale, derisa me përqindje më të vogël në sektorët: hotelieri dhe turizëm, si dhe shëndetësi dhe mbrojtje sociale. Ndërsa edhe në kategorinë tjetër, të anketuarit japin përgjigje për profile që bëjnë pjesë në shërbime personale.

Tabela 4: Sektorë në të cilët ofruesit e shërbimeve për AJFRR ofrojnë programe

Sektor	Përqindje e ofruesve
Shërbime personale	50,0%
Hotelieri dhe turizëm	20,0%
Shëndetësi dhe mbrojtje sociale	10,0%
Tjetër (përmendni çfarë)	20,0%

Të anketuarit/ofruesit e trajnimeve në rajonet e projektit, në vitin 2017 dhe 2018 nuk kanë pasur ofertë të trajnimeve në sektorët: makineri, sektorin bujqësor, sektorin ushqimor-teknokogjik, sektorin e makinerisë dhe elektroteknikës – IT-profile.

Sipas përgjigjeve nga ekzemplari i shkollave të mesme profesionale që janë ofruesë të shërbimeve, rreth dy të tretat e SHMP-ve ofrojnë programe nga sektori i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale (66,7 %), derisa më pak janë të përfaqësuar sektori elektroteknik; dhe në kategorinë “tjetër” përmenden profesioni i

komunikacionit dhe makineria. Përfaqësuesit e anketuar të komunave u përgjigjen se ofrojnë më së shumti programe nga shëndetësia dhe përkujdesi social, si dhe programe që nuk bëjnë pjesë në sektorët e përmendur në pyetësin, si p.sh.: pastrues të oxhakut në objekte banimi që përdorin karburant të ngurt dhe të lëngët, turizëm dhe zhvillim lokal ekonomik (TZHLE) etj.

Numri i përgjithshëm i programeve për arsimim joformal të të rriturve që i kanë ofruar të anketuarit në vitin 2017 dhe 2018 ka qenë 45, që bën të ditur në faktin se një ofrues i shërbimeve për AJFRR ka verifikuar më shumë programe.

Interes për shërbimet/trajnimet e ofruara për arsim joformal

Lidhur me interesimin e pjesëmarrësve në trajnimet për AJFRR-në, ofruesit e trajnimeve janë përgjigjur se në vitin 2017 dhe 2018 interes më të madh ka pasur për trajnimet nga sektori i shërbimeve personale (60 % e të anketuarve), pjesa tjetër janë në sektorin e hotelerisë (20 %), shëndetësi dhe përkujdesje sociale (10 %).

Përfaqësuesit e komunave të përfshira në ekzemplarin kanë dhënë informacione se interesim më të madh në mesin e pjesëmarrësve ka pasur për trajnimet për gjuhë të huaj, makineri dhe për pastrues të oxhakëve. Përfaqësuesit e komunave kanë informuar se në nivel të komunës, në sektorë të ndryshëm, në vitin 2017 dhe 2018 janë realizuar gjithsej 28 programe për AJFRR, ndërsa janë trajnuar gjithsej 1904 persona të moshuar.

Tabela 5: Struktura e pjesëmarrësve në programet për AJFRR që kanë qenë të përfshirë në trajnimet për vitin 2017 dhe 2018

Struktura e të trajnuarve *	% nga numri i përgjithshëm i të trajnuarve
Femra	66,7%
Persona me status të pavolitshëm socio-ekonomik	66,7%
Persona me pengesë	3,2%
Persona të përkatësisë etnike rome	14,2%
Persona të mjedisit rural	66,7%
Persona të punësuar	38,1%
Persona të papunë	61,9%

* Një person në të shumtën e rasteve paraqitet në më shumë se një kategori.

Sipas të dhënave të ofruesve të shërbimeve (tabela 5), mund të konstatohet se shumica e pjesëmarrësve në trajnime kanë qenë me status të pavolitshëm dhe/ose të marginalizuar në më shumë baza.

Struktura e nxënësve në AMP nuk dallon shumë në raport me strukturën e pjesëmarrësve në arsimin dhe trajnimin joformal. Në tabelën e mëposhtme, është paraqitur përfaqësimi procentual i nxënësve sipas kategorive në pyetësin për shkollat si ofruese të trajnimeve në arsimin formal.

Mund të vërehet se në AMP, në shkollat që janë përgjigjur në pyetësin, nuk janë përfshirë persona me pengesë, ndërsa personat e përkatësisë etnike rome janë të përfaqësuar me një përqindje shumë të vogël (gjë që është e ndërlidhur edhe me pjesëmarrjen e përgjithshme të nxënësve romë në arsimin e mesëm). Për dallim nga pjesëmarrësit në AJFRR, në AMP ka përqindje më të vogël (10,1 %) e nxënësve me status të pavolitshëm socio-ekonomik. Që te të dyja llojet e trajnimeve (në sistemin formal dhe joformal) në ekzemplarin (rajone dhe sektorë) dominon popullata femërore.

Tabela 6: Struktura e nxënësve në AMP për vitin 2017 dhe 2018 në shkollat që janë përgjigjur në pyetësin

Struktura e nxënësve*	% nga numri i përgjithshëm i nxënësve
Nxënës femra	60,3%
Persona me status të pavolitshëm socio-ekonomik	10,1%
Persona me pengesë	0,0%
Persona të përkatësisë etnike rome	1,1%
Persona të mjedisit rural	42,2%
Persona të punësuar (nëse shkolla është e verifikuar si ofrues i trajnimeve për të moshuar)	0,0%
Persona të papunë (nëse shkolla është e verifikuar si ofrues i trajnimeve për të moshuar)	0,0%

* Një person mund të paraqitet në më shumë se një kategori

Mënyra në të cilën ofruesit e shërbimeve/ trajnimeve vendosin për ofertën e tyre

Që të merren informacione për atë se sa ofruesit e shërbimeve kujdesen për nevojat e tregut të punës për profile të caktuara, ata janë pyetur për mënyrën në të cilën marrin informacione për

nevojën e një programi të caktuar për arsim dhe trajnim. Përgjigjet e tyre janë paraqitur në tabelën e radhës.

Tabela 7: Mënyra në të cilën ofruesit e shërbimeve për AJFRR marrin informacione për nevojën e programit të caktuar për arsim dhe trajnim

Përgjigjet e të anketuarve	% ofrues
Hulumtim personal për kërkesën	60,0%
Të dhëna nga Agjencia për Punësim	10,0%
Interes dhe kërkim të pjesëmarrësve potencial të ardhshëm në trajnimet	20,0%
Nevojat për trajnime nga donatorë në Republikën e Maqedonisë	10,0%
Nevoja dhe kërkesa nga vetëqeverisja lokale	0,0%
Programe të mbështetura nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë	0,0%

Mund të konstatohet se ofruesit e shërbimeve për AJFRR kur vendosin për ofertën për trajnim, në të shumtën e rasteve udhëhiqen nga vlerësimi dhe analiza personale për nevojat e tregut të punës, por nuk përdorin raporte plotësuese dhe analiza të thella që bëjnë të ditur për atë se cilat profesione dhe drejtime të caktuara janë deficitare. Gjithashtu, është evidente se nuk


ka/ose ka bashkëpunim shumë të vogël mes vetëqeverisjes lokale/komunave dhe ofruesit të shërbimeve për AJFRR që të ofrohen trajnime përkatëse me nevojat e bizneseve lokale. Përveç kësaj, është evidente se nuk përdoren mundësitë për realizimin e programeve që i mbështetë Qeveria.

Karakteristika të shfrytëzuesve të shërbimeve/pjesëmarrës në trajnimet

Konstatimi lidhur me gjininë e pjesëmarrësve në trajnime i mbështetur në të dhënat e ofruesit të shërbimeve në AJFRR vërtetohet edhe nga të dhënat e pyetësorit në të cilin u përgjigjën shfrytëzuesit e shërbimeve/pjesëmarrës në trajnime. Dominon popullata femërore (76 %), përballë asaj mashkullore (24 %).

Lidhur me sektorin e trajnimeve që e parapëlqejnë të anketuarit e gjinisë së ndryshme, popullata femërore është e interesuar për profesione kushtimisht thënë "femërore" edhe atë shërbime personale, si dhe shëndetësi dhe mbrojtje sociale, derisa popullata mashkullore i ka zgjedhur trajnimet nga fusha e makinerisë, bujqësisë,

Grafikon 4: Ndjekja e trajnimeve sipas sektorëve dhe gjinisë



PËRQINDJE E TË ANKETUARVE

peshkatarisë, veterinarisë, etj.. Në Grafikonin e mëposhtëm janë paraqitur përgjigjet në pyetjen: *Nga cili sektor është trajnimi që e ndoqët?*

Në raport me interesin që e kanë të punësuarit/të papunët e anketuar për përvetësimin dhe/ose përsosjen e kompetencave të tyre përmes programeve për AJFRR, mund të konstatojmë se dominon kategoria të anketuar të papunë, gjë që është edhe e logjikshme duke marrë parasysh atë se ata kanë nevojë më të madhe për t'i përsosur

kompetencat e tyre dhe të plasohen në tregun e punës. Mirëpo, nuk duhet të nënçmojmë as numrin e të anketuarve të punësuar që i kanë ndjekur trajnimet për AJFRR, që do të thotë se ka nevojë për përsosje ose fillon të zhvillohet vetëdija për nevojën e nxënies së përhjetshme në fushën personale dhe profesionale të jetës.

Në tabelën e radhës janë paraqitur të dhënat për statusin e pjesëmarrësve në trajnimet (të punësuar dhe të papunë) sipas gjinisë.

Tabela 8: Përqindje dhe numër i pjesëmarrësve në trajnimet për AJFRR sipas statusit të punës dhe gjinisë

	I punësuar		I papunë		Gjithsej
Meshkuj	37,1%	11	63,0%	17	28
Femra	38,9%	33	61,2%	52	85
Gjithsej		44		69	113

Është evidente se trajnimet më shpesh janë ndjekur nga personat e papunë përballë personave të punësuar dhe me këtë rast dominon popullata femërore. Në kuadër të kategorive i punësuar – i papunë, nuk ka dallim të konsiderueshëm statistikor sipas gjinisë.

Përshtatshmëria e ofertës së programeve për AJFRR me kërkesën

Pyetëtori përmbante pyetje që kishte të bëjë me përshtatshmërinë e programeve që ofrohen për AJFRR me kërkesën e tyre në tregun e punës. Qëndrimet e të katër kategorive të të anketuarve janë në drejtim të asaj se oferta e programeve është përkatëse me kërkesën.


Me fjalë të tjera::

- ▶ 90 % e ofruesve të anketuar të shërbimeve për AJFRR janë përgjigjur se mbajnë llogari për atë që programet për arsimimin e të rriturve që i ofrojnë të kenë kërkesë në tregun e punës.
- ▶ Dy të tretat e përfaqësuesve të shkollave të mesme profesionale (66,67 %) gjithashtu u pajtuan se për profilet që i ofrojnë në shkollat ka kërkesë në tregun e punës.

- ▶ Shumica e përfaqësuesve të anketuar të komunave u pajtuan se në komunën e tyre ofrohen programe për të cilat ka kërkesë në tregun e punës.

Qëndrimet e përmendura më parë u mbështetën edhe me mendimin e pjesëmarrësve në trajnimet të cilët janë përgjigjur se pajtohen se *dituritë, shkathtësitë dhe qëndrimet që i kanë përvetësuar në trajnimin janë bashkëkohore dhe në përputhje me kërkesën në tregun e punës.*

Grafikon 5: Mendimet e të anketuarve për përshtatshmërin e ofertës së programeve me kërkesën e tregut të punës (nuk ka përgjigje në kategoritë "fare jo" dhe "kryesisht jo")



PËRQINDJE E TË ANKETUARVE

Analiza e diskutimeve në grupet e fokusit me përfaqësuesit e ofruesve të verifikuar të shërbimeve lidhur me pyetjen e orientimit të tregut të programeve të tyre të verifikuara i vërtetoi qëndrimet paraprake dhe mund të shtohet edhe ajo se programet janë me orientim të pjesshëm të tregut për vendet e Evropës Perëndimore dhe një pjesë e madhe e tashmë pjesëmarrësve të trajnuar në trajnimet kanë shkuar për të punuar në ndonjë prej vendeve evropiane.

Në grupet e fokusit është dhënë iniciativë, para përpilimit të programeve për AJFRR vetë entet/institucionet të bëjnë hulumtime më të thella për nevojat e tregut dhe në bazë të rezultateve të fituara të përpilojnë programe. Gjithashtu, është përmendur se një pjesë e ofruesve të shërbimeve bëjnë analiza rrënjësore për nevojën personale, e

disa thjeshtë i ndjekin nevojat e klientëve me të cilët bashkëpunojnë.

Është interesante e dhëna se 83,4 % e të anketuarve – përfaqësues të shkollave të mesme profesionale, janë prononcuar se nxënësit punësohen lehtë në profesionin/profilin përkatës pasi të mbarojnë arsimin. Kjo, bashkë me përgjigjet e analizuara paraprakisht, bie ndesh me të dhënat për papunësinë, të siguruar nga APRM–ja dhe rezultatet nga Studimi¹² për vëzhgimin e nxënësve dhe studentëve që kanë mbaruar më 2016–ën, ku sipas të dhënave të analizuara – gjashtë muaj pas përfundimit të arsimit profesional, më pak


¹² Tracing secondary vocational and tertiary education graduates in the former Yugoslav Republic of Macedonia, fq.5, <https://www.etf.europa.eu/en/publications-and-resources/publications/tracing-secondary-vocational-and-tertiary-education>

se gjysma (41%) e nxënësve që kanë mbaruar shkollën e mesme janë evidentuar si kërkues atraktiv të punës dhe një pjesë e vogël e tyre (21%) kanë qenë të papunë.

Kjo gjithashtu vërtetohet edhe me qëndrimet e nxënësve lidhur me mundësitë për punësim

pas trajnimit të përfunduar. Me fjalë të tjera, shfrytëzuesit që i kanë ndjekur trajnimet për AJFRR në pyetjen lidhur me atë nëse dituritë, shkathhtësitë dhe qëndrimet që i kanë përvetësuar në trajnimin u kanë ndihmuar që të punësohen, kanë mendime të ndara (Grafikon 6).

Grafikon 6: Qëndrime të shfrytëzuesve të shërbimeve për AJFRR lidhur me pohimin "dituritë, shkathhtësitë dhe qëndrimet që i përvetësova në trajnimin më ndihmuan që të punësohem më shpejtë"




PAJTUESHMËRI ME POHIMIN

PJESËMARRËS NË TRAJNIMET

Te shfrytëzuesit e shërbimeve për AJFRR ka mendime të ndara në raport me atë se dituritë, shkathhtësitë dhe qëndrimet e përvetësura në trajnimin kanë ndihmuar për avancim në vendin e punës, thuajse 1/3 nuk u ka ndihmuar fare, ndërsa

pak më shumë se 1/3 u ka ndihmuar (Grafikoni 7). Mund të supozohet se kjo është e ndërlidhur edhe me atë nëse vizitimi i trajnimit ka qenë vendim personal ose nga ana tjetër rekomandim i punëdhënësit.

Grafikon 7: Pajtueshmëri e pjesëmarrësve në trajnim për AJFRR lidhur me atë se "dituritë, shkathtësitë dhe qëndrimet që i përvetësova në trajnim më ndihmuan të përparoj në vendin e punës"



PJESËMARRËS NË TRAJNIMET

Shfrytëzuesit/pjesëmarrësit në trajnimet konsiderojnë se kanë nevojë për kompetenca plotësuese për punësim ose për përparim në vendin e punës, gjë që perceptohet nga niveli i pajtueshmërisë së tyre me pohimin "kam nevojë t'i sendërtoj kompetencat e mia që të punësohem dhe/ose t'u përgjigjem nevojave të vendit të punës". Lidhur me këtë, 71,4 % e të anketuarve konsiderojnë se kanë nevojë për sendërtimin e kompetencave, ndërsa vetëm 18,7 % mendojnë se kanë kompetenca të mjaftueshme për t'u përgjigjur në vendin e punës. Këto përgjigje, gjithashtu, pjesërisht nuk pajtohen me pohimin e përqindjes më të madhe të ofruesve të trajnimit se oferta është e orientuar drejt nevojave të tregut të punës.

Që të zgjidhet situata me modernizimin e kompetencave të nxënësve, më shumë se dy të tretat e të anketuarve nga shkollat e mesme profesionale pajtohen se *do të duhet të bëhet përshtatje e programeve mësimore drejt tendencave bashkëkohore nga profesioni/profili përkatës.*

3.2. Gjithëpërfshirje e programeve për arsimim joformal të të rriturve

Gjithëpërfshirja e programeve për arsimim joformal është një prej parakushteve për krijimin e sistemit modern për arsimim dhe trajnim ku nuk do të ekzistojë diskriminim i natyrës etnike, gjinore, fetare, racore dhe i natyrës tjetër dhe ku personat e kategorive të rrezikuara, si dhe personat me pengesë do të mund ta realizojnë potencialin e tyre, do të bëhen pjesëmarrës aktiv në tregun e punës dhe do të kontribuojnë për zhvillimin e tyre personal dhe zhvillimin e shoqërisë në tërësi.

Lidhur me gjithëpërfshirjen e programeve, në secilin prej instrumenteve kishte grup të pyetjeve. Gjatë analizës së përgjigjeve është bërë indeks i agreguar nga pyetjet përkatëse (pikat) dhe është bërë përlogaritje plotësuese e përqindjes nga të anketuarit (përgjigjet në kategorinë “nuk kam mendim” janë të koduara).


Përshkrim më i hollësishëm i pyetjeve që janë përdorur për indeksin për gjithëpërfshirje është paraqitur në Tabelën 9.

Tabela 9: Pyetje lidhur me gjithëpërfshirjen

Kod	Të anketuar	Përshkrim i pikave në instrumentin
AA	Ofrues të shërbimeve për arsimimin e të rriturve	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Mundësi për aftësimin e programit për trajnim në AJFRR për persona me pengesë ▶ Qasje në programin në më shumë gjuhë (maqedonisht, shqip, etj.) ▶ Struktura gjinore, fetare dhe etnike e trajnuesve
AB	Shkolla të mesme profesionale	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Mundësi për qasje, kushte dhe pjesëmarrje për persona me pengesë ▶ Qasje të programeve mësimore në më shumë gjuhë (maqedonisht, shqip, turqisht, etj.) ▶ Struktura gjinore, fetare dhe etnike e arsimtarëve
AC	Shfrytëzues të programeve për AJFRR	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Diskriminim gjatë trajnimit ▶ Persona me pengesë në grupin në të cilin kanë qenë të trajnuar ▶ Realizimi i trajnimit në gjuhën amtare të pjesëmarrësve ▶ Gjinia, përkatësia fetare dhe etnike e trajnuesve
AD	Komuna	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Qasje e programit në gjuhë të ndryshme (maqedonisht, shqip, etj.) ▶ Oferta e programit të jetë e kapshme për të gjithë pa dallim të përkatësisë nacionale, etnike, racore, gjinore dhe gjendjes shëndetësore

Në bazë të indeksit konstatohet se:

Grafikon 8. Vlerësim i ofruesve dhe pjesëmarrësve të trajnimeve për gjithëpërfshirjen e ofertës



PËRQINDJE E TË ANKETUARVE

- ▶ 44,5 % e ofruesve pajtohet se oferta e trajnimit është gjithëpërfshirëse; dhe
- ▶ 59,4 % e shfrytëzuesve të arsimit joformal për të moshuarit pajtohet se trajnimi të cilin e kanë kaluar është gjithëpërfshirës.
- ▶ Mund të konstatohet se ka dallim të rëndësishëm statistikor në përgjigjet që kanë të bëjnë me gjithëpërfshirjen mes ofruesve të trajnimeve dhe shfrytëzuesve të AJFRR (në kategorinë „Tërësisht po”), me ç’rast ofruesit janë gjithnjë e më shumë kritik (ndoshta për shkak se ata e kuptojnë më mirë gjithëpërfshirjen).

Më tutje, në Raportin janë analizuar më hollësisht aspektet dhe përgjigjet e të anketuarve lidhur me gjithëpërfshirjen e ofertës dhe trajnimeve.


Mosha e pjesëmarrësve në trajnimet

Është evidente se pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në trajnimet për AJFRR (rreth dy të tretat) janë të moshës mbi 30 vjeç edhe te popullata mashkullore edhe te ajo femërore. Kjo supozon se kjo është kategoria e moshës që ka nevojë më të madhe për avancimin e kompetencave të saj ose nga ana tjetër për përvetësimin e të reja.

E dhënë interesante është edhe përqindja e personave femra që kanë marrë pjesë në trajnime e që janë në moshën 15-18 vjeçe (ndonëse është vetëm 2,4 %), për shkak se këta janë persona të cilët sipas rregullativës ligjore do të duhej të jenë në sistemin formal të arsimit të mesëm.

Paraqitja e strukturës së moshës së shfrytëzuesve që janë përfshirë me hulumtimin është dhënë në Grafikonin vijues.

Grafikon 9: Struktura e moshës e pjesëmarrësve në trajnime sipas gjinisë



PËRQINDJE E TË ANKETUARVE

Përkatësia etnike e pjesëmarrësve në trajnimet

Të dhënat për sistemin e shfrytëzuesve të programeve për arsimim joformal të të rriturve që

janë përfshirë në hulumtimin sipas përkatësisë etnike, janë paraqitur në tabelën 10.

Tabela 10: Shfrytëzues të shërbimeve të AJFRR-së sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë

	maqedonas/e	shqiptar/e	rom/e	serb/e	tjetër (ceke)	Total
Meshkuj	74,1%	14,8 %	11,1 %	0,0 %	0,0 %	100%
Femra	60,0%	33,0 %	3,5 %	2,4 %	1,2 %	100%

Mund të vërejmë se, sipas përkatësisë etnike në ekzemplarin e shfrytëzuesve të shërbimeve të AJFRR-së, në hulumtimin në sektorët dhe rajonet

e projektit më së shumti janë të përfaqësuar maqedonasit me 67 %, më pas shqiptarët me 23,9 %, romët me 7,3 % dhe serbët me 2,4 %.

Duhet të theksohet se duke marrë parasysh shkallën e lartë të papunësisë në mesin e romëve, e cila sipas APRM-së arrin 6,1 % (sipas gjendjes më 31.12. të vitit 2017), përfaqësimi i tyre në trajnimet për AJFRR është shumë i vogël (edhe atë veçanërisht gjinia femërore). Niveli i ulët arsimor, si dhe kualifikimet jopërkatese për plasman në tregun e punës gjithësesi janë një arsye më tepër për përjashtimin social të këtij grupi të marginalizuar. Arsyet për përfshirjen e ulët në AJFRR mund të jenë të natyrës së ndryshme: mungesë e financave (për shkak se për pjesën më të madhe të programeve nevojitet vetëfinancim nga pjesëmarrësit), informim i pamjaftueshëm, mungesë e ofertës së programeve në gjuhën rome, etj.

Niveli arsimor i pjesëmarrësve në trajnimet

Lidhur me nivelin arsimor, shfrytëzuesit e programeve për AJFRR janë pyetur për nivelin më të lartë të tyre të arsimit që e kanë kryer para trajnimit. Në bazë të përgjigjeve të tyre, mund të konstatojmë se përqindja më e madhe e tyre janë me arsim të mesëm (77 %), me përqindje më të vogël ka pjesëmarrës me arsim të lartë (14,2 %) dhe me arsim fillor (8,9 %). Nuk ka pjesëmarrës në programet që ishin të paarsimuar, gjë që është e logjikshme, meqë parakusht për përfshirje në cilindo nga programet e AJFRR-së është së paku arsimit fillor.

Këto të dhëna, të cilat kanë të bëjnë me trajnimet për AJFRR në vitin 2017 dhe 2018 dhe të katër rajoneve dhe shtatë sektorëve në Projektin, janë në përputhje me të dhënat e hulumtimit Arsimim i të rriturve në vitin 2016 (kapitulli 1 në këtë Raport).

Qasje deri te programet për grupe të ndryshme

Sipas përgjigjeve të ofruesve të anketuar të shërbimeve për AJFRR, thuajse të gjithë (90 %) mbajnë llogari *programet që i ofrojnë të jenë të kapshme për të gjitha kategoritë e qytetarëve pa dallim të përkatësisë së tyre fetare, nacionale, etnike, racore dhe gjinore, si dhe gjendjes shëndetësore*. Ofruesit e shërbimeve, gjithashtu, (rreth 80 %) konsiderojnë se programet që i ofrojnë janë të kapshme dhe/ose lehtë të përshtatshme për persona me pengesë.

Këto qëndrime janë të mbështetura edhe me mendimin e shfrytëzuesve të programeve për AJFRR. Thuajse 85 % e tyre janë prononcuar se *gjatë trajnimit nuk kanë ndjerë diskriminim të çfarëdo lloji* (fetar, nacional, etnik, racor, gjinor, etj.).

Një përqindje e caktuar (18,8 %) e shfrytëzuesve të programeve për AJFRR deklaruan se *në trajnimin që e kanë ndjekur, kanë marrë pjesë edhe persona me nevoja të posaçme*. Kjo është e dhënë inkurajuese, gjegjësisht fillojnë të rrenohen paragjykimet për personat me pengesa dhe ata përgatiten për përfshirjen e tyre në tregun e punës. Gjithashtu, është me rëndësi të përmendet se ofruesit e programeve, në grupet e fokusit deklaruan se janë të gatshëm të bëjnë ndryshime dhe përshtatje të programeve dhe realizim të trajnimeve në përputhje me nevojat specifike dhe pengesën dhe janë të gatshëm të sigurojnë trajnues përkatës që do të ndihmonte që ata të përparojnë më mirë në përvetësimin e kompetencave.


Krahasuar me ofruesit e trajnimeve në AJFRR, shumica e të anketuarve nga AMP-ja u prononcuan se nuk kanë fare ose kryesisht nuk kanë kushte për nxënie të nxënësve me nevoja të posaçme arsimore. Kjo e dhënë është dëshpëruese duke marrë parasysh faktin se koncepti i

gjithëpërfshirjes tashmë një dekadë të tërë është i mundur me ligj në arsimin formal dhe të detyrueshëm. Kjo vetëm dëshmon angazhimet deklarative të strukturave udhëheqëse për gjithëpërfshirje në shkolla.

Në raport me kuadrin që është i përfshirë në realizimin e programeve për AJFRR dhe në

realizimin e programeve mësimore nga AMP-ja, do të mund të konstatohej se parimi gjithëpërfshirës respektohet në raport me gjininë, si edhe përkatësisë etnike dhe fetare të kuadrin mësimor. Ngjashmëria e qëndrimeve të të gjitha kategorive të anketuara në hulumtimin është evidente në Grafikonin e paraqitur më poshtë.

Grafikon 10: Balancim i kuadrin mësimor/trajnuës sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe fetare



PËRQINDJE E TË ANKETUARVE

Sipas përgjigjeve të përfaqësuesve nga ofruesit e programeve nga grupet e fokusit, programet ofrohen në më shumë gjuhë, e nëse ka nevojë sigurohen trajnues ose përkthyes që pjesëmarrësit të mund të ndjekin trajnimin në mënyrë të papenguar.

Interesim për programet e grupeve të ndryshme

Lidhur me interesimin për trajnime të caktuara që e tregojnë pjesëtarët e bashkësive të ndryshme etnike, mund të thuhet se ekziston dallim mes maqedonasve, shqiptarëve dhe romëve për sektorin në të cilin është trajnimi.

Në Grafikonin e mëposhtëm janë paraqitur të dhënat për të anketuarit sipas nacionalitetit dhe interesimit të tyre për trajnim në profesione/profile të ndryshme.

Grafikon 11: Sektorë që i kanë përzgjedhur pjesëmarrësit në trajnim të përkatësisë së ndryshme etnike

Ushqimore teknologjike

- ▶ 0,0%
- ▶ 0,0%
- ▶ 4,2%

Shëndetësi dhe përkujdesje sociale

- ▶ 83,3%
- ▶ 0,0%
- ▶ 56,3%

Hoteleri dhe turizëm

- ▶ 0,0%
- ▶ 3,7%
- ▶ 4,2%

Shërbime personale

- ▶ 6,7%
- ▶ 89,0%
- ▶ 27,1%

Makineri

- ▶ 10,0%
- ▶ 7,4%
- ▶ 8,3%

- ▶ Përkatësi rome
- ▶ Përkatësi shqiptare
- ▶ Përkatësi maqedonase

PËRQINDJE E TË ANKETUARVE

Mund të vërehet se pjesëmarrësit në programet për AJFRR të nacionalitetit maqedonas më së shumti janë të interesuar për trajnime nga sektori i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, si dhe për sektorin shërbime personale.

Pjesëtarët e bashkësisë etnike shqiptare, nga ana tjetër, me thujse 90 %, janë të interesuar për të vizituar programet nga sektori e shërbimeve personale.

Përgjigjet e pjesëtarëve femra të nacionalitetit rom treguan se janë të interesuara për programe nga sektorët shëndetësi dhe shërbime personale, ndërsa burrat romë krahas këtyre dy sektorëve janë të interesuar edhe për programe nga fusha e makinerisë.

3.3. Realizim i programeve për arsimim joformal të të rriturve

Cilësia e realizimit të programeve për arsimim joformal të të rriturve është njëri prej parakushteve themelore për shfrytëzuesit përfundimtar të këtyre trajnimeve që të përvetësojnë kompetenca përkatëse nga profesioni/profili për të cilin trajnohen, që është tregues indirekt për plasmanin e tyre të suksesshëm në tregun e punës. Cilësia në krijimin dhe realizimin e AJFRR-së gjithashtu ndikon edhe në atraktivitetin e trajnimeve të ofruara, po edhe në strukturën financiare të vetë trajnimit.

Temat e hulumtimit përmes të cilave e analizojmë cilësinë e realizimit të programeve kanë të bëjnë me: shfrytëzimin e metodave dhe teknikave bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse mësimore për mësimdhënie gjatë realizimit të programeve, kompetencën e trajnuesve/arsimtarëve për profesion/profil përkatës, si dhe shfrytëzimin e veglave, makinave, materialeve, pajisjes bashkëkohore dhe ngjashëm në përputhje me nevojat e vendeve të punës për të cilat trajnohen pjesëmarrësit.

Metoda dhe teknika mësimore

Përfaqësuesit e shkollave të mesme profesionale janë të përmbajtur në raport me shfrytëzimin e metodave dhe teknikave bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse mësimore për mësimdhënie në programet mësimore. Gjysma e tyre u prononcuan se nuk kanë mendim, ndërsa 16,7 % u prononcuan se nuk shfrytëzohen metoda bashkëkohore mësimore. Kjo bën të ditur në faktin se kuadrit mësimor të arsimit të mesëm i nevojitet mbështetje për përvetësimin dhe sendërtimin e kompetencave të tyre për zbatimin e mësimi bashkëkohor, si dhe specifika për profesion/profil përkatës.

Pjesëmarrësit e anketuar të trajnimeve për AJFRR pajtohen me pohimin se *trajnuesit kanë poseduar dituri, shkathtësi dhe kompetenca bashkëkohore nga profesioni/profili përkatës, që do të thotë se për realizimin e programeve për AJFRR janë angazhuar trajnues përkatës.*

Gjatë prononcimit të ofruesve të trajnimeve në kuadër të grupeve të zbatuara të fokusit shprehën mendimin se ka vështirësi në gjetjen e

trajnuesve për profesione të caktuara specifike (si për shembull bravëndreqës ose saldues) dhe se më vështirë harmonizohen terminët për realizimin e trajnimeve me angazhimin profesional të trajnuesit. Ofruesit pajtohen plotësisht se trajnuesit që i kanë angazhuar përdorin metoda dhe teknika bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse mësimore.

Në Grafikonin 12 janë paraqitur përgjigjet lidhur me metodat dhe teknikat e mësimi nga të tri grupet e të anketuarve.

Arsyeja për dallimet e mëdha në përgjigjet e kësaj pyetjeje në mesin e të anketuarve nga arsimit formal dhe nga arsimit joformal ndoshta është, realizimi ende më shumë tradicional i programeve mësimore në shkollat për arsim të mesëm profesional, por edhe kritika e pamjaftueshme gjatë përgjigjes në pyetjet nga ofruesit për trajnim në AJFRR.

Grafikon 12: Qëndrimet e të anketuarve lidhur me shfrytëzimin e metodave bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse mësimore gjatë realizimit të mësimi/trajnimeve

Tërësisht po

▶ 0,0%



Kryesisht po

▶ 33,3%

▶ 0,0%

▶ 16,8%

Nuk kam mendim

▶ 50,0%

▶ 0,0%

▶ 0,9%

Kryesisht jo

▶ 16,7%

▶ 0,0%

▶ 5,3%

Jo fare

▶ 0,0%

▶ 0,0%

▶ 0,9%

■ SHMP

■ Ofrues në AJFRR

■ Shfrytëzues të trajnimeve në AJFRR

PËRQINDJE E TË ANKETUARVE

Shfrytëzimi i veglave, makinave, materialeve, pajisjes dhe ngjashëm gjatë trajnimit


Të gjithë ofruesit e shërbimeve për AJFRR u prononcuan se përdorin vegla, makina, materiale dhe ngjashëm, në përputhje me nevojat e vendeve të punës. Nga Grafikoni i mëposhtëm mund të konstatohet se edhe mendimet e pjesëmarrësve në trajnime janë thuajse identike, derisa nga ana tjetër mendimet e përfaqësuesve të shkollave të mesme profesionale dallojnë në masë të konsiderueshme.

Arsyeja për dallimin e këtillë është për shkak se shumica e ofruesve të shërbimeve për AJFRR janë kompani private që për realizimin e programit

tentojnë t'i sigurojnë të gjitha materialet, veglat e nevojshme, etj., derisa nga ana tjetër shkollat e mesme profesionale janë institucione shtetërore që nuk kanë resurse dhe mjete të mjaftueshme që do të ishin përkatëse me profesionin.

Por, ka edhe ofrues të shërbimeve për AJFRR, të cilët për profesione të caktuara specifike kanë vështirësi të furnizohen me aparaturë dhe materiale përkatëse, pjesërisht për shkak të pafuqisë së tyre financiare dhe çmimit të ulët të trajnimeve.

Grafikon 13: Përgjigjet e të anketuarve lidhur me shfrytëzimin e veglave, makinave, materialeve, pajisjes bashkëkohore dhe ngjashëm në përputhje me nevojat e vendeve të punës.



PËRQINDJE E TË ANKETUARVE

3.4. Bashkëpunim në kuadër të mjedisit shoqëror

Zhvillimi i programeve të kapshme, bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse për arsimim joformal të të rriturve dhe arsimit dhe trajnimit joformal profesional, mes tjerash varen nga bashkëpunimi i vendosur i ofruesve të këtyre shërbimeve me bashkësinë lokale dhe bashkësinë më të gjerë shoqërore. Në kuadër të këtij hulumtimi të anket-

uarit nga tri kategoritë: ofruesit të cilët ofrojnë trajnime në AJFRR, shkollat e mesme profesionale dhe vetëqeverisja lokale, janë pyetur për nivelin e bashkëpunimit të tyre me punëdhënësit, me Qendrën për Arsimimin e të Rriturve dhe me Agjencinë për Punësim.

Bashkëpunim me punëdhënësit

Nga përgjigjet që janë marrë në *pyetësorët* mund të thuhet se ofruesit për arsimimin joformal të të rriturve kanë ndërtuar një bashkëpunim të caktuar me sektorin e biznesit, me arsimin sipëror, si dhe me institucionet shtetërore që ofrojnë mbështetje gjatë krijimit dhe realizimit të programeve për arsimim joformal të të rriturve.

Me fjalë të tjera, 80 % e ofruesve të shërbimeve për AJFRR pohojnë se kanë realizuar bashkëpunim me sektorin e biznesit. Por, këto përgjigje në pyetësor, nuk vërtetohen me të dhënat që janë marrë nga *grupet e fokusit*. Përfaqësuesit e ofruesve, deklarojnë për këtë se nuk ekziston bashkëpunim i mirë as me vetëqeverisjen lokale as me punëdhënësit, veçanërisht në raport me:

- ▶ analizën e saktë për atë se cilat trajnime dhe kualifikime janë të nevojshme; dhe
- ▶ mundësinë për të realizuar pjesën praktike të trajnimit për përvetësimin e shkathtësive në kompanitë.

Të anketuarit nga shkollat e mesme profesionale deklarojnë se ekziston bashkëpunim me punëdhënësit. Rreth dy të tretat e këtyre të anketuarve janë prononcuar se bashkëpunojnë me sektorin e biznesit për realizimin e mësimit praktik dhe se pjesa më e madhe e nxënësve trajninim praktik e realizojnë në kompanitë lokale.

Bashkëpunim me institucionet

Në sistemin e AJFRR-së, është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi me institucionin Qendër për Arsimimin e të Rriturve (QARR), si dhe me Agjencinë për Punësim (APRM). Lidhur me këtë, të anketuarit nga të gjitha kategoritë: ofrues të AJFRR-së, komuna dhe shkolla të mesme profesionale, kanë qëndrim kryesisht pozitiv. Kjo u konfirmua edhe nga përgjigjet në pyetësorët, por

edhe nga të anketuarit nga grupet e realizuara të fokusit.

Të dhënat tregojnë se:

- ▶ më shumë se gjysma e të anketuarve nga komunat janë përgjigjur se kryesisht bashkëpunojnë me sukses me QARR-in për verifikimin e programeve për arsim dhe trajnim joformal; dhe
- ▶ 70% e ofruesve kanë deklaruar se bashkëpunojnë me APRM-në, por 10% nuk bashkëpunojnë fare ndonëse për ta ky institucion do të duhej të jetë njëri prej burimeve kryesore për kërkesë, gjegjësisht ngopje të tregut të punës me profile të caktuara.

Informim për ofertën e programeve

Informacioni i rëndësishëm në këtë hulumtim për orientimin drejt tregut të programeve që ofrohen në AJFRR është, sa janë në njëfarë mënyre "të orientuar drejt tregut" vetë ofruesit e trajnimeve, në kuptim të asaj se në çfarë mase dhe në çfarë mënyre i informojnë shfrytëzuesit e mundshëm të ardhshëm të shërbimeve të tyre.

Lidhur me këtë i pyetëm pjesëmarrësit në trajnime për atë se si kanë ardhur deri te informacioni se ofrohet trajnimi që e kanë vizituar. Nga përgjigjet e tyre mund të konstatohet se më së shumti janë informuar përmes mediave elektronike (televizionit, radios, internetit, reklamave), por edhe se kanë informacione nga APRM-ja. Një përqindje më e vogël e tyre informohen nga pjesëmarrësit paraprak në trajnime, ndërsa më së paku nga vetëqeverisja lokale.

Kjo tregon fuqinë që e kanë mediat për të depërtuar deri te ata të cilëve u nevojitet shërbim nga fusha e AJFRR, por edhe mbështetjen institucionale nga APRM-ja si stozher në mesin e institucion-


eve të tjera për orientim dhe sigurim të trajnimeve dhe mundësive për punësime.

Por, nuk është për nënçmim edhe e dhëna se thuhetse 1/4 e pjesëmarrësve në trajnimet marrin informacione nga pjesëmarrësit paraprak në trajnimin e njëjtë. Kjo është e dhënë e rëndësishme që bën të ditur se ofruesit e shërbimeve në AJFRR duhet të kujdesen vazhdimisht dhe të ngrisin nivelin personal të atraktivitetit dhe cilësisë së trajnimeve që i ofrojnë.

Brengosëse është pjesëmarrja minimale e vetëqeverisjes lokale në informimin dhe promovimin e arsimit dhe trajnimit joformal, veçanërisht për shkak se ajo duhet të jetë vendi ku në nivel lokal bashkohen nevojat e kompanive dhe oferta e institucioneve për arsim dhe trajnim formal dhe joformal.

The minimal participation of the local self-government is concerning, given that it should link the private sector needs and the supply of VET/ NFET institutions at local level.

Grafikon 14: Përgjigjet e pjesëmarrësve të trajnimeve lidhur me marrjen e informacioneve për programet për AJFRR



REFLEKTIVE PËRFUNDIMTARE



Disa nga funksionet themelore të arsimit dhe trajnimit profesional, si dhe arsimimit të të rriturve, janë që të përmirësojnë qasjen e të rinjve dhe të rriturve deri te mundësitë për punë, t'u mundësojnë përparim në tregun e punës, por edhe të rrisin potencialin e tyre. Zhvillimi i këtyre funksioneve do të kontribuojë drejt uljes së shkyçjes së tyre nga bota e punës dhe shoqërisë në tërësi. Vetëm përmes aftësimit të vazhdueshëm drejt nevojave të ndryshueshme të tregut bashkëkohor të punës, me vendosjen e inovacioneve në mësimdhënie dhe realizimin e trajnimeve, me respektimin dhe realizimin e plotë të konceptit të gjithëpërfshirjes në kontekst të nxënies së përrjetshme, të rinjtë dhe të moshuarit mund të ndihmojnë që të ulen varfëria dhe dallimet sociale dhe t'i mbështesin proceset për zhvillim të qëndrueshëm.

Analiza e të dhënave që janë marrë nga hulumtimi i realizuar tregon kompleksitetin e çështjes për orientimin drejt tregut dhe gjithëpërfshirjen e

programeve për arsimim joformal të të rriturve. Duhet cekur se gjatë analizës dhe interpretimit të rezultateve vërejtëm dukurinë e përgjigjeve të dëshiruara sociale gjë që paraqitet te thujse të gjitha hulumtimet shoqërore kryesisht për shkak të mentalitetit që sundon në këtë nënqiell, si dhe frikës për të shprehur mendimin e sinqert personal (veçanërisht nëse ajo nuk është në përputhje me atë që e konsiderojnë të anketuarit se dëshiron ta dëgjojë hulumtuesin). Meqë në hulumtimin janë përfshirë të anketuar që kanë ofruar ose ndjekur trajnime për arsimim joformal në shtatë sektorë ekonomik dhe katër rajone të planifikuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nuk është e pëlqyeshme që konstatimet të përgjithësohen.

Lidhur me **orientimin drejt tregut të programeve për arsimim joformal të të rriturve**, secila kategori e të anketuarve konsideron se programet për arsimim joformal të të rriturve që ofrohen në masë të madhe janë në përputhje me kërkesat e tregut

të punës. Por, këto qëndrime mund t'i konsiderojmë si subjektive, meqë në hulumtimin e mëtejshëm të mendimeve të tyre mësuam se të anketuarit në një përqindje shumë të vogël shërbehen me analiza dhe dokumentacion plotësues për profesione dhe drejtime deficitare në shtet dhe se përballen me mungesë të drejtimeve strategjike për zhvillimin e profesioneve deficitare. Analiza e hollësishme na flet se edhe gjatë punësimit, pjesëmarrësit në trajnimet përballen me nevojën e kompetencave plotësuese për punësim ose për avancim në vendin e punës. Kjo bën të ditur në atë se ka nevojë për aftësimin e programeve mësimore drejt tendencave bashkëkohore nga profesioni/profili përkatës me qëllim që të sigurohet plasman përkatës në tregun e punës, si dhe të rritet atraktiviteti i vetë programeve.

Gjithëpërfshirja e programeve për arsimimin joformal të të rriturve si një nga parakushtet për krijimin e sistemit bashkëkohor për arsim dhe trajnim, ku nuk do të ekzistojë diskriminim të natyrës etnike, gjinore, fetare, racore dhe të natyrës tjetër dhe ku personat e kategorive të rrezikuara, si dhe personat me pengesë do të mund të realizojnë potencialin e tyre dhe do të mund të bëhen pjesëmarrës aktiv në tregun e punës, mund të konstatojmë se respektohet në mënyrë deklarative. Kjo është e evidente në pohimet e ofruesve të programeve për AJFRR të cilët mbajnë llogari që programet të cilat i ofrojnë të jenë të kapshme për të gjitha kategoritë e qytetarëve. Këto qëndrime janë të mbështetura edhe me mendimet e shumicës së shfrytëzuesve të programeve për AJFRR, të cilët *gjatë trajnimit NUK kanë ndjerë diskriminim të çfarëdo lloji*. Gjithashtu, është me rëndësi të përmendet se ofruesit e programeve për AJFRR janë të gatshëm të bëjnë ndryshime në programet mësimore për këtë kategori të qytetarëve në përputhje me pengesën e tyre dhe të sigurojnë trajnues përkatës që do të ndihmonte ata të përparojnë më mirë në përvetësimin e kompetencave.

Mirëpo, të anketuarit nga AMP-ja deklaruan se nuk ekzistojnë kushte për nxënie të nxënësve me nevoja të posaçme arsimore.


Lidhur me kuadrin mësimor që është përfshirë në realizimin e programeve për AJFRR, si dhe programet mësimore nga AMP-ja, mund të thuhet se parimi i gjithëpërfshirjes respektohet në raport me përcaktimin etnik, gjinor dhe fetar. Respektohet edhe parimi i realizimit të programeve për AJFRR në gjuhën amtare të pjesëmarrësve ashtu që nëse ka nevojë sigurohen trajnues ose nga ana tjetër përkthyes për disa programe të caktuara dhe materiale mësimore.

Për **cilësinë e realizimit të programeve për arsimin joformal të të rriturve** ekziston dallim në mendimet për kompetentshmërinë e kuadrit mësimor për zbatimin e metodave dhe teknikave përkatëse bashkëvepruese gjatë realizimit të procesit mësimor mes kategorive të të anketuarve. Me fjalë të tjera, përgjigjet e të anketuarve bëjnë të ditur se trajnuesit e përfshirë në AJFRR në masë të madhe përdorin metoda bashkëkohore të mësimdhënies. Në AMP ka mungesë të veglave, makinave, materialeve, pajisjes bashkëkohore, etj. në përputhje me nevojat e vendeve të punës, që do të thotë se nxënësit nuk janë në gjendje të përvetësojnë kompetenca përkatëse. Me problemin e njëjtë përballen edhe ofruesit e programeve për AJFRR për profesione të caktuara specifike, të cilat kanë vështirësi të furnizohen me aparaturë dhe materiale përkatëse, por kanë vështirësi edhe të gjejnë trajnues me kompetenca përkatëse dhe bashkëkohore për mësimdhënie.

Lidhur me **bashkëpunimin me mjedisin më të ngushtë dhe më të gjerë shoqëror mund të konstatohet** se ofruesit e shërbimeve për arsim joformal të të rriturve kanë vendosur bashkëpunim bazik me sektorin e biznesit, arsimin e lartë, si dhe me institucionet shtetërore që ofrojnë mbështetje gjatë krijimit dhe realizimit të programeve për arsimim joformal të të

rriturve. Sipas përfaqësuesve të intervistuar nga AJFRR-ja konstatohet edhe ajo se nuk ekziston bashkëpunim mjaft i mirë me vetëqeverisjen lokale dhe punëdhënësit në raport me analizën precize për atë se cilat trajnime dhe kualifikime janë të nevojshme, si dhe për realizimin e shkathtësive praktike të një pjesë e kompanive.

Përfaqësuesit e intervistuar nga ofruesit e shërbimeve për AJFRR (në kuadër të grupeve të fokusit) konsiderojnë se nuk kanë bashkëpunim të mirë me vetëqeverisjen lokale dhe kurrfarë mbështetje gjatë krijimit dhe realizimit të programeve të tyre. Lidhur me bashkëpunimin me IP Qendrën për Arsimimin e të rriturve dhe Agjencinë për Punësim, të anketuarit nga të gjitha kategoritë kanë qëndrim pozitiv gjë që është tregues i mirë për besimin mes sektorit shtetëror dhe privat për realizimin e qëllimeve arsimore.



LITERATURA E SHFRYTËZUAR



- Cedefop (2017). On the way to 2020: data for vocational education and training policies. Country statistical overviews – 2016 update. Luxembourg: Publications Office. Cedefop research paper; No 61
- ETF (European Training Foundation)/VET Centre, 2017. Torino Process 2016-2017, National report of Republic of Macedonia, Skopje, 2016
- ETF, Torino Process 2018-2020, National Reporting Template, the Former Yugoslav Republic of Macedonia, 2018
- European Commission, 2016. A New Skills Agenda for Europe, Working together to strengthen human capital, employability and competitiveness, {SWD(2016) 195 final}, Brussels, 10.6.2016, COM(2016) 381 final
- European Commission, Draft 2015 joint report of the Council and the Commission on the implementation of the Strategic framework for European cooperation in education and training (ET 2020), COM(2015) 408 final
- Ligji për arsimimin e të rriturve (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 07 e vitit 2008)
- Ligji për arsim të mesëm (Gazeta zyrtare e RM-së nr.52 e vitit 2002)
- Ligji për Kornizë Nacionale për Kualifikime, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 137/2013 dhe 30/2016
- Ligji për arsim dhe trajnim profesional (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 71 më 08.06.2006)
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Qendra për Arsim dhe Trajnim Profesional, 2010. Koncept për arsimim pas shkollës së mesme
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Baza të Kornizës Maqedonase të Kualifikimeve, Mbështetje teknike e BE-së deri te Ministria e Arsimit dhe Shkencës për projekte për nxënie të përgjeshme 2013
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Strategji për Arsim dhe Trajnim Profesional në kontekst të nxënies së përgjeshme 2013-2020 me Plan veprimi, Shkup, 2013
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Koncept për modernizimin e arsimit teknik, 2016
- Projekt i Bankës Botërore për zhvillimin e shkathtësive dhe mbështetje të inovacioneve (SDIPR), Ligj për arsimimin e të rriturve (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 07 ngajjanari i vitit 2008)
- Severity of the Issue of Excluded Young People in Macedonia from Education, Trainings and Employment: How to Cope With? UTMS Journal of Economics 8 (3): 295-306., Blagica Novkovska, 2017

Vasill Gjorgov nr. 16 1000, Shkup
Republika e Maqedonisë së Veriut

